

V E N D I M
Nr. 488, datë 14.8.2001

**PËR LEJIMIN E BANKËS SË KURSIMEVE SH.A. TË BËJË RIVLERËSIMIN E PASURIVE
TË PALUAJTSHME TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 70 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Bankës së Kursimeve sh.a. të bëjë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, që janë sot në shfrytëzim të saj, duke marrë parasysh proceset inflacioniste.
2. Përdorimin e njërës nga metodat IAS, të përcaktuara nga vetë Banka e Kursimeve sh.a. për këtë rivlerësim.
3. Diferencat e rezultateve nga rivlerësimi të kalojnë në llogarinë “Rezerva nga rivlerësimi”. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta